

Kapitulli 2 Gjuha Shqipe

PIKËPAMJET DHE KONTRIBUTI I GJERGJ FISHTËS PËR GJUHËN STANDARDE SHQIPE

Prof. Asoc.dr. Elona ÇEÇE, Universiteti i Korçës “Fan S. Noli”

e-mail: ecece@unkorce.edu.al

Dr. Lindita KAÇANI, “Universiteti i Korçës “Fan S. Noli”

lkacani@unkorce.edu.al

Abstrakt

Ky punim trajton qëndrimin e Gjergj Fishtës ndaj gjuhës shqipe dhe në veçanti ndaj gjuhës standarde, duke u mbështetur në shkrimet e tij publicistike në revistën “Hylli i Dritës” gjatë periudhës 1914–1930. Fishta, si njohës i mirë i gjuhës shqipe dhe i disa gjuhëve të huaja, përfaqësonte një zë të rëndësishëm në debatin për politikën gjuhësore shqiptare. Analiza e këtyre shkrimeve tregon jo vetëm qëndrimet e tij mbi formimin e standardit, përdorimin dhe zhvillimin e shqipes, por edhe ndikimin e faktorëve historikë dhe kulturorë që kushtëzuan mendimin e tij. Në tekstet e tij vihet re një qasje e qëndrueshme dhe largpamëse në përkrahje të ruajtjes së gjuhës shqipe, vlerësimit të potencialit të dialektit të toskërishtes në krijimtarinë letrare, dhe nevojës për unifikimin e gjuhës. Vështruar nga këndvështrimi i sotëm, këto ide ruajnë aktualitetin dhe vlefshmërinë e tyre, duke treguar rolin parësor që Fishta i atribuonte gjuhës si instrument i identitetit kombëtar dhe zhvillimit kulturor.

Fjalë çelës: varietet, standard, zhvillim gjuhësor, faktorë historikë dhe kulturorë

Gjergj Fishta's views and contribution to the standard Albanian Language

Abstract

This paper examines Gjergj Fishta's position on the Albanian language, with a focus on the standard variety, based on his journalistic writings published in the magazine Hylli i Dritës between 1914 and 1930. As a speaker, researcher, and connoisseur of Albanian and several foreign languages, Fishta's perspectives offer valuable insight into early Albanian language policy. The analysis of his writings reveals not only his views on the formation, use, and development of the standard language, but also the historical and cultural factors that shaped those views. His consistent support for preserving the Albanian language, recognizing the literary potential of the Tosk dialect, and promoting linguistic unity is evident throughout his work. Viewed from a contemporary perspective, Fishta's ideas remain relevant, reflecting his foresight and the importance he attributed to language as a core element of national identity and cultural development.

Keywords: standard variety; language development; historical and cultural factors.

Hyrje

Në këtë punim do të trajtojmë qëndrimin e Gj. Fishtës për gjuhën shqipe dhe veçanërisht për gjuhën standarde, duke u mbështetur në shkrimet e tij publicistike në revistën "Hylli i Dritës" nga viti 1914 deri më 1930. Qëllimi i punimit: përmes qëndrimit të Fishtës lidhur me formimin e standardit, të zbulojmë largpamësinë e tij dhe vlerëshmërinë e alternativës së tij, sepse duke qenë lëvrues i shqipes, studiues dhe njohës i gjuhëve të huaja, natyrisht mendimi i tij përbënte një orientim të vlershëm për politikën gjuhësore në Shqipëri. Literatura bazë që u shfrytëzua për këtë punim është: "Gjergj Fishta", Vepra, 9, Publicistika; 'Hylli i dritës', (Botimet Fishta, Lezhë, 2012) dhe "Histori e gjuhës standarde shqipe", (SHBLU, Miço Samara, Tiranë, 2005).

Metodologji

Përmes materialit të cituar nga shkrimet publicistike të Fishtës: do të analizojmë qëndrimin e tij të kushtëzuar edhe nga faktorët historikë edhe kulturorë të kohës; do të sintetizojmë, me përfundime konkrete lidhur me pikëpamjet e tij; si dhe do të vlerësojmë nga këndvështrimi i sotëm rëndësinë e këtyre shkrimeve publicistike.

Analizë

Në botimin "Histori e gjuhës standarde shqipe" për debutimin e Gjergj Fishtës lidhur me njësimin e gjuhës shqipe pak është përmendur kontributi i tij, përveçse kur bëhet fjalë për "Komisinë Letrare të Shkodrës"²¹³. Një nga arsytet është se botimi i plotë i publicistikës së Fishtës u bë vetëm më 2012 nga Hamit Boriçi dhe Ndue Zef Toma, të cilët i dhanë lexuesit një koleksion të revistës "Hylli i dritës", një prej organeve më prestigjioze të shtypit shqiptar.

Duke analizuar shkrimet e tij publicistike sipas renditjes kohore, në harkun kohor 1914 -1930 vërejmë se ajo çka parashton Fishta në shkrimet publicistike është në përputhje me kushtet historike dhe kulturore në Shqipëri. Sipas tij, nevojitet:

1. ruajtja dhe mësimi gjuhës shqipe;
2. vlerësimi i potencialit të dialektit të toskërishtes në veprat letrare të shkruara në variantin letrar të toskërishtes;
3. njësimi i shqipes.

Lidhur me çështjen e parë mund të përmendim: tre artikuj të rëndësishëm "Koha e re në Shqipni", (Shkruar në "Hylli i dritës, 1914/6); "Rrokull Shqipnisë" ("Hylli idritës, 1914/7) dhe "Gjuhë mësimi", "Hylli idritës, 1914/8.

Në artikullin e parë, Fishta shkruan:

Ka Shqipni, ka... se Perëndia i amëshuem e ka shkruar me shkronja ari në libër guri të paçmuem, në qelër të Parrizit, që kombi shqiptar ka me rrnuë i lumnueshëm...ka mujtë me mbajtëvetvetsinë e gjuhën e vet kombëtare të papecatun e thjesht shqiptare. Edhe sot, po shqip lutet Zoti në Shqipni, shqip i këndohet lahutës zatore nëpër malet tona, e shqip zihet vallja e kanga ndër të kremtet argëtime të votrës së shqiptarit"²¹⁴

²¹³ Më shumë për Komisionë Letrare mund të lexoni edhe tek Nathanaili (2016: 23-24).

²¹⁴"Gjergj Fishta", Vepra, 9, Publicistika, f.99.

Dy vjet pas shpalljes së pavarësisë shqipja shfaqej si një gjuhë që e kishte ruajtur sistemin e saj dhe përdorej masivisht. Dihet që shpallja e pavarësisë nuk gjeti në Shqipëri një shtresë dy-gjuhësore shqip turqisht, gjë që përbënte një përparësi që ajo të ngrihej në nivelin e një gjuhe zyrtare. Gjithashtu, nga shtatori i vitit 1913 ishin hapur shkollat shqipe me vendim të qeverisë shqiptare.²¹⁵ Në shkrimin "Rrokull Shqipnisë"²¹⁶ duke shkruar për kabinetin e ministrive në Shqipëri (mars, 1914) ngre domosdoshmërinë e ligjit për shqipen si gjuhë zyrtare.

"...se këta zotni të ndertë e bujarë, njerëz dijeje e pune e të regjun në atdhedashtni, kanë me ditë e me ia dhanë të mbarën vendit tonë...Ministeri sot për sot, mundet me ba një një punë fort të mirë për Shqipërinë që nuk lyp as shumë pare, as kohë, as mund, e kishte me qenë mbas mendimit tim: me vu ligjë që: a) gjuha shqipe të jetë gjuhë zyrtare ndër të gjitha zyrat e shtetit tonë; b) që ndër të gjitha shkollat fillore të Shqipërisë, në dashtë të jenë qeveritare, në dashtë të veçanta, gjuha shqipe të jetë gjuhë mësimi... Ky ligj kishte qenë i nevjshëm fort për Shqipërinë; pse gjuha asht faktori ma i parë i njësisë kombëtare, e pse asht e arsyeshme që populli të rritet mbas një mësimi të njinshëm e të homogjenshëm. Nuk do lanë gjithmonë Shqipëria kullë Babeli"²¹⁷

Por për Fishtën një rëndësi të madhe merr mësimi i shqipes sidomos në shkollat fillore. Në shkrimin "Gjuhë mësimi", Fishta shkruan se pavarësisht besimit, kombësisë, apo rregullit a pushtetit të veçantë, që të jetë shkolla, duhet të përdoret gjuha shqipe. Për Fishtën shkollat fillestare nuk janë seminare liturgjike. Shkollat nuk janë "vegla politike", por janë troje të bekueme ku do të trajtohet karakteri i njeriut."²¹⁸ Është e rëndësishme të theksojmë se ai del me një platformë konkrete të cilën po e paraqitim më poshtë:

"Gjuhë mësimi.- Klasa I, Ushtrime në këndim e në të folun. Ushtrime gatuese (përgatitore) gjuhë vrojtimi, tue ndjekë ato sende që gjenden përreth fëmijës. ... Të përfolun mbi landë të këndimit; ushtrime të lehta në përkthim të nxjerruna prej librit të këndimit.
Klasa II, Ushtrime në të folun, të përhapun të landës së këndueme mbas të pyetunash. Ushtrime ortografie me kujdes të posacëm të zgjatunit e të ndamit e rrokjeve; folje e thjeshtë dhe veçme; emën përshtues, verb tri kohët e para të verbit. Ushtrime të nxjerruna prej librit.
Ky asht program i gjuhës së mësimt ose i gramatikës, të cilën mësuesi do t'ia zhvillojë fëmijës në I e në II klasë fillestare."²¹⁹

Duke e analizuar këtë program mund të zbulojmë qartësinë e Fishtës në mendimin gjuhësor e metodik, lidhur me të fituarit e kompetencës së të folurit, si dhe të kompetencës gramatikore ku mbizotëron teknika e të pyeturit, "me bazë të pyetunash" shkruan Fishta.

Mësimi i shqipes apo edhe i gjuhëve të huaja edhe sot e kësaj dite në shkollat tona ka një platformë të tillë. Por po kaq i rëndësishëm sa parashtrimi i një programi të tillë, është edhe argumentimi që i bëhet domosdoshmërisë së mësimt të shqipes, ku në mënyrë të veçantë spikat një pyetje përgjigje: "Tash ne po shtrojmë kuvendin në këtë mënyrë: a mund të thohet me arsye se në një shkollë fillestare, ku për gjuhë mësimi nuk përdoret gjuha shqipe, njeriut i trajtohet karakteri, si e lypë detyra e tij? Për tamam që jo; pse në atë shkollë njeriu nuk nxë me nderue e çmue gjuhën e vet, si e ka me detyrë, tue qenë që gjuha asht nga të parat mjete për me u mbajtë njënia e independenca e kombit., ndaj të cilit asht i detyruem secili shqiptar."²²⁰

²¹⁵ A. Puto, Pavarësia e Shqipërisë dhe diplomacia e fuqive të mëdha, 1912-1914, 1978, f.121.

²¹⁶"Gjergj Fishta", Vepra, 9 Publicistika, f.122.

²¹⁷"Gjergj Fishta", Vepra, 9 Publicistika, f.125.

²¹⁸"Gjergj Fishta", Vepra, 9 Publicistika, f.135.

²¹⁹"Gjergj Fishta", Vepra, 9, Publicistika, f.136.

²²⁰"Gjergj Fishta", Vepra, 9, Publicistika, f.138.

Fishta e ka të qartë që rruga e formimit të standardit, pra e njësimit të gjuhës nuk është një rrugë e dosidoshme, por është një rrugë që duhet të udhëhiqet nga mendimi i specializuar. Ai e ka të qartë se njësim do të thotë një rrugë e natyrshme dhe jo e sforcuar e përzgjedhjes së atyre formave gjuhësore që do të ngrihen në nivelin e normës gjuhësore. Por Fishta, megjithëse shkruante në variantin e gegërishtes veriperëndimore, vlerëson në mënyrë objektive edhe variantin e toskërishtes dhe shprehet se koha do të bëjë të mundur përzgjedhjen e njërit apo tjetrit dialekt, si gjuhë letrare, e cila s'mund të jetë në asnjë mënyrë bashkim mekanik i dialekteve. Duke vlerësuar botimin e "Ëndrra e lotë" të Asdrenit të "Hylli i dritës, (1914/9) ai shkruan: "Mbas mendimit tim, ky libër shfaq ma së miri çka të hijshëm në vetvete dialekti i Toskënisë. Do shqiptarë kur shkruajnë shqip e përziejnë gegënishten me toskënishten në një mënyrë aq të vrazhdë, sa mos me t'u ba me e këndue. Ajo s'asht gjuhë: ajo asht si mushku, që s'asht as kalë as gomar. Për me u përba gjuha letrare nuk është nevoja me krijue një gjuhë të re: lypet vetëm me e njëjtë gjuhën e me i ditë rregullat e saj mirë, e mbasandej me i rreshtue fjalët në shkrim me mjeshtëri; e atëherë koha e dija e estetika kanë me gjykue se cili dialekt do zgjedhë për gjuhë letrare në Shqipëri"²²¹

Këtu duhet të theksojmë se pikëpamja e Fishtës bie ndesh me atë të Ndre Mjedës, i cili siç dihet ishte anëtar i shoqërisë bashkimi dhe më pas drejtues i shoqërisë "Agimi". Mendimi i tij ishte për një bazë dialektore të përbashkët dhe për këtë ai "i këshillonte nxënësit e tij të përdornin në shkrimet e tyre elemente gjuhësore jo vetëm nga shkodranishtja, por edhe nga të folmet e tjera të gegërishtes dhe toskërishtes"²²²

Gati pas një dekade të shpalljes së pavarësisë ende përbënte shqetësim për Fishtën fakti se si duhet të bëhet Shqipëria, "Nuk asht e mjaft që lulet të çelin, por duhet edhe të lidhin për me u pjek pema."²²³, të "Koha e ardhshme e Shqipërisë"²²⁴, "Hylli idritës", 1923/2.

Ai konstaton: "...pse me çka duket, parlamenti s'merret me çështje shkollore- sado që e di, se për shumë arsye shqiptarit, posë gjuhës së vet, i duhet me ditë edhe një gjuhë të madhe evropiane". Largpamësia e tij qëndron në faktin se ky mësim i gjuhës evropiane kishte rëndësi shumë të madhe lidhur me depërtimin e kulturës evropiane në Shqipëri. Kjo kulturë natyrisht do të kishtë ndikimi edhe në zhvillimin e shqipes duke qenë se sistemi i shqipes do të vendosej përkrah sistemit të këtyre gjuhëve. Vlerësimin për toskërishten dhe potencialin e saj si një burim për pasurimin e mbarë shqipes, Fishta e shpreh në shkrimin "Bleta shqiptare- e Thimi Mitkos, "Hylli idritës", 1924/2. E përshkroi me shkronja shqip dhe e radhiti Dr. Gjergj Pekmezi, konsull i Shqipërisë- Vjenë, 1924(nëntitull).

Ai vlerëson punën e Pekmezit: "ka një meritim të posaçëm për përkthimin dhe ribotimin e librit fort interesant të Thimi Mitkos: pse me të shton një dokument të ri për historinë e popullit shqiptar, zgjanon edhe ma tepër gurrën e gjallë të gjuhës sonë amtare." Dhe më poshtë përfundon duke theksuar rëndësinë e këtij botimi: "Si po shihet, libri ka një randësi të madhe në pikëpamje të gjuhësisë e të folklorit. Merret vesh prej vetes, se asht shkruar për njerëz literarë, e jo për nxanës shkollash. I lumtë zotit dr. Pekmezit! Tri herë i lumtë!"²²⁵

Një "Atentat shurdh", "Hylli idritës", 1930/12 është artikulli ku do të thoshim se një rëndësi të veçantë merr pikëpamja për gjuhën e njesuar. Fishta arsyen që në Shqipëri nuk po shkruhej më një vepër

²²¹"Gjergj Fishta", Vepra, 9, Publicistika, f.155.

²²²Fadil Raka, Histori e shqipes letrare, 1997, f 150.

²²³"Gjergj Fishta", Vepra, 9 Publicistika, f.231.

²²⁴"Gjergj Fishta", Vepra, 9 Publicistika, f.243.

²²⁵"Gjergj Fishta", Vepra, 9 Publicistika, f.396.

letrare e re me vlera, duke lënë "anash arsyet psikologjike, kulturore, morale, etnike etj. e kërkon në faktin se "ashtë ndryshimi i pikëpamjeve të shqiptarëve mbi caktimin e njenit a tjetrit dialekt për gjuhë letrare në Shqipëri" Fishta nuk e mbështet "Gjuhën e Elbasanit".

Në këtë rast ai bën krahasimin me gjuhën e Dante Aligerit, i cili nuk do ta kishte shkruar dot veprën e vet, po të mos kishte përdorur dialektin e Toskanës. Ai kundërshton vendimin e qeverisë që të shkruhej "Gjuha e Elbasanit".

Po këtu Fishta citon shembuj nga shtypi përmbi "shëmtimin" që po i bëhej shqipes, "me të shti të drdhunat", shprehet ai. Në këtë "shëmtim" ai sheh rrezikun e humbjes së gjuhës. "Tue qenë edhe na të zanatit, e kuptojmë mirë fort, se gazetarët nuk janë të detyruem të shkruajnë literaturë në fletore të veta dhe se shumë herë janë të ngushtuem me përdorue ndër shkrime fjalë të hueja...Mos të harrojmë se me e bjerrë gjuhën, do me thanë me bjerrë kombësinë e pavarësinë." Së fundi, në shkrimin: "A jemi shqiptarë a do të bahemi?" Fishta në mënyrë filozofike rendit kushtet e të qenit "njësi kombëtare". "Ma i qarti shenj i kombësisë asht njësia e gjuhës. ...Gjuha me të vërtetë dan si të ishte e vetmja gërvojë (gëzhjojë) e nacionalizmit..."²²⁶

"qe shkurtazi, pasqyra, në të cilën do të shikohemi a jemi e sa jemi shqiptarë...e për këtë lidhni na flet ma i pari e ma i madhi visar i rodit të shqiptarit, që asht gjuha e përbashkët"²²⁷

Konkluzione

Dy vjet pas shpalljes së pavarësisë shqipja shfaqet si një gjuhë që e kishte ruajtur sistemin e saj dhe përdorej masivisht, ngre domosdoshmërinë e ligjit për shqipen si gjuhë zyrtare. Në programin e hartuar për klasën I dhe II-të të shkollës fillore mund të zbulojmë qartësinë në mendimin gjuhësor e metodik, lidhur me fitimin e kompetencës së të folurit, si dhe të kompetencës gramatikore, ku mbizotëron teknika e të pyeturit. Fishta, megjithëse shkruante në variantin e gegërishtes veriperëndimore, vlerëson në mënyrë objektive edhe variantin e toskërishtes dhe shprehet se koha do të bëjë të mundur përzgjedhjen e njërit apo tjetrit dialekt si gjuhë letrare, e cila s'mund të jetë në asnjë mënyrë bashkim mekanik i dialekteve. Mësimi i një gjuhe të madhe evropiane kishte rëndësi shumë të madhe lidhur me depërtimin e kulturës evropiane në Shqipëri. Kjo kulturë natyrisht do të kishte ndikim edhe në zhvillimin e shqipes duke qenë se sistemi i shqipes do të ballafaqohej me sistemin e këtyre gjuhëve. Ai kundërshton vendimin e qeverisë që të shkruhej "Gjuha e Elbasanit" si dhe shtron nevojën e ruajtjes së pastërtisë së leksikut të shqipes. Njësia e gjuhës, sipas Fishtës, është dëshmi e njësisë së kombit.

Referenca

Fishta, Gj. (2012). *Vepra 9: Publicistika, "Hylli i Dritës"*. Lezhë: Botimet Fishta.

Gjinari, J., & Shkurtaç, Gj. (2000). *Dialektologjia shqiptare*.

Haxhi, A., & Topalli, T. (1998). *Historia e gjuhës së shkruar*.

Lloshi, Xh. (1998). *Mbështetje për gjuhën letrare*.

Nathanaili, V. (2016). *Rruga e mundimshme e shkollës shqip: Çështje, politika & veprimtari në fushën e arsimit, 1912–1944*. Tiranë: UET Press.

Puto, A. (1978). *Pavarësia e Shqipërisë dhe diplomacia e fuqive të mëdha, 1912–1914*.

Raka, F. (1997). *Histori e shqipes letrare*.

Samara, M. (2005). *Histori e gjuhës standarde shqipe*. Tiranë: SHBLU.

Sinani, A. (2024, 6 qershor). Kongresi i Manastirit – 116 vite nga alfabeti që na bashkoi: Dokumentet arkivore, artikuj dhe fotografi. *Monografi Akademike Shqiptare*.

²²⁶"Gjergj Fishta", *Vepra, 9 Publicistika*, f.514.

²²⁷"Gjergj Fishta", *Vepra, 9 Publicistika*, f.517.